



KAPITULLI 7

E drejta mbi pronësinë intelektuale

Kuadri ligjor i BE-së përmban rregulla të harmonizuara për të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI). Këto të drejta janë gjithashtu të mbrojtura nga legjislacioni ndërkombëtar dhe ai i shteteve anëtare, por legjislacioni i BE-së harmonizon aspekte të DPI-ve për të siguruar mbrojtje të njëtrajtëshme të tyre në të gjithë tregun e brendshëm.

Pronësia intelektuale përfshin të gjitha të drejtat ekskluzive të krijimeve intelektuale, të cilat grupohen në dy lloje të drejtash:

1. Të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to mbulojnë pronësinë letrare, artistike dhe shkencore, përfshi letërsinë, veprat muzikore, veprat e arteve pamore, veprat audiovizuale, literaturën profesionale e shkencore, etj.
2. Të drejtat e pronësisë industriale që përfshijnë:
 - a) shpikjet (patentat);
 - b) markat tregtare;
 - c) disenjot industriale; dhe
 - d) treguesit gjeografik.

Në mënyrë më specifike pronësia industriale përfshin patentat për shpikje, markat tregtare (të produkteve dhe kompanive), projektimet industriale. Të mbrojtura janë edhe programet dhe bazat e të dhënave kompjuterike, topografite e gjysmëpërçuesve, transmetimet

satelitore apo ritransmetimet kabllore. Rregulla të veçanta mbulojnë produktet farmaceutike dhe bioteknologjike, si dhe varietet e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e tyre. Në fushën ushqimore të mbrojtura janë edhe përcaktimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë të produkteve, pra emrat e produkteve që tregojnë vendin ku janë bërë, për të ndalur imitimin dhe abuzimin e tyre.

Bashkimi Europian ka harmonizuar edhe rregullat për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, përfshi qasjen në drejtësi.

Si në shumë fusha, krijimi i kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe administrative për zbatimin e ligjeve duke garantuar në praktikë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë është gjithashtu kërkesë e rëndësishme e procesit të përgatitjes për anëtarësim. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të garantohet hetimi dhe vlerësimi i ankesave për shkelje të këtyre të drejtave, si dhe mundësia që pretendimet apo mosmarrëveshjet të dëgjohen dhe të zgjidhen në mënyrë efektive nga sistemi i drejtësisë. Po ashtu, kërkohen aftësi për të luftuar falsifikimin dhe imitimin.

Grupe me interes për t'u përfshirë:

Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve; Albautor; shoqatat e botuesve; shoqatat e artistëve, universitetet, mediat, botuesit, institucionet kërkimore dhe shkencore, shoqatat farmaceutike, prodhuesit farmaceutikë, përfaqësuesit e autorizuar për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, agjensitë e administrimit kolektiv të të drejtave; firmat ligjore në fushën e pronësisë intelektuale.

Institucioni udhëbeqës i negociatave:

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale

Institucione kyçe të përfshira në negociatë:

- Ministria e Financave
- Akademia e Shkencave
- Ministria e Industrisë, Energjisë dhe Transportit
- Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Ministria e Bujqësisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Gjykatat Administrative